

# Politikat shtetërore nën komunizëm

Elena Marushiakova, Veselin Popov

Korniza e përgjithshme dhe tiparet specifike | Vendosja e romëve shëtites | Integrimi i përshpejtuar | Trashëgimia kulturore dhe historike | Organizatat – “lëvizjet romani” në Jugosllavi | Integrimi publik dhe/ose asimilimi

➤ Në fund të Luftës së Dytë Botërore u shfaq ajo që zyrtarisht quhej “Blloku Socialist” në pjesën më të madhe të Evropës, ku një numër i konsiderueshëm i romëve evropian jetonin. Në pajtim me ideologjinë e re komuniste, ndryshimet e përgjithshme sociale dhe ekonomike ndodhën në këto vende, duke ndikuar në tërë popullsinë, përfshirë romët. Përkundër parametrave të përbashkët ideologjik, politikat ndaj “Ciganëve” nuk ishin identike, kishte dallime, bazuar në modelet e të kaluarës dhe strategjitë nacionale. Qëllimi kryesor i politikave të shteteve ishte integrimi në shoqëri, i cili në disa shtete arriti fazën e përpjekjes drejt asimilimit.

## PARATHËNIE

Fundi i Luftës së Dytë Botërore dhe vitet pasuese sollën ndryshime radikale në vendet e Evropës lindore. Partitë lokale komuniste erdhën në pushtet në Poloni, Çekosllovakia, Hungari, Rumania, Bullgaria, Jugosllavi dhe Shqipëri me përkrahjen aktive të Bashkimit Sovjetik dhe vendosën kontroll të plotë në të gjitha sferat e jetës publike. U krijua një lloj i ri i sistemit shtetëror-politik, që sipas frazeologjisë së vet, definohej si “socialist”. U bënë ndryshimet e përgjithshme sociale dhe ekonomike, ku disa nga to drejtpërdrejtë ndërlidheshin me “Ciganët”, të cilët në shkallë të ndryshme dhe në periudha të ndryshme ishin gjithashtu shënjestër e politikës aktive të qeverisë.

### KORNIZA E PËRGJITHSHME DHE TIPARET SPECIFIKE

Kur flitet për të ashtuquajturin “Bllok Socialist” në Evropën lindore, shpesh fitohet përshtypja se kjo shprehje i referohet sistemit njëbllokësh totalitar, drejtpërdrejtë nën sundimin e Moskës, ku një politikë e përbashkët

dominonte të gjitha sferat. Deri në një shkallë të lartë kjo ishte e vërtetë, por prapë mbeten mjaftë dallime dhe tipare specifike në vendet e ndara. Uniteti njëbllokësh i vendeve në Evropën lindore, i udhëhequr nga partitë politike u shpërbë kah fundi i viteve të 1940-ta në Jugosllavi. Në vitet e 1950-ta Shqipëria gjithashtu mori drejtimin e saj. Përkundër anëtarësimit në Traktatin e Varshavës dhe Comecon, Ruma-

nia në shumë aspekte demonstroi – në një shkallë të vogël – një “pavarësi” të caktuar. Brenda disa nuancave, kjo gjithashtu u shfaq në vendet e tjera të Evropës lindore. [III. 1]

Në fakt nuk është e mundur të flitet për ekzistencën e ndonjë lloji të modelit të përgjithshëm për vendet e Evropës lindore posaçërisht në sferën e politikës nacionale. Në sipërfaqe, në nivelin ideologjik, kishte një unitet total,





III. 2  
*Bakërpunues, Rumania, në vitin 1956.*  
(nga G. Lükö, nga Fraser 1992, f. 280)



III. 3  
*Ursari (trajnuet i arinjve), Bullgari.*  
(nga Rolf Bauerdick, nga Guy 2001, f. 328)



III. 4  
*Punuesit e qymyr drurit, Bullgari.*  
(nga Rolf Bauerdick, nga Guy 2001, f. 328)



III. 5  
*Tregtarët e metalit nga Meteol, Rumani.*  
(nga Djurić / Becken / Bensch 1996, f. 184b)



III. 6  
*Tregtari i kuajve, Rumania.*  
(nga Djurić / Becken / Bensch 1996, f. 184b)



III. 7  
*Punuesit e tullave nga Craiova, Rumani.*  
(nga Djurić / Becken / Bensch 1996, f. 184b)

dhe secili vend deklaronte se politika e saj nacionale ishte e bazuar në “parimet e Marksizëm-Leninizmit”; sidoqoftë në praktikë gjërat ishin mjaft ndryshe.

Duke folur në mënyrën më të përgjithshme ekzistonin dy modele të politikës nacionale në Evropën lindore, që do të mund të definohej si “etno-nacionale” dhe si “post-imperiale”. Kjo e para dominonte në Poloni, Hungari, Rumani, dhe Shqipëri (Çekosllovakia gjithashtu do të mund të përfshihej në këtë grup përveç disa rezervimeve – ishte një shtet federal, i përbërë nga dy vende). Këto vende përbënin një shtet (në Çekosllovakia dy) që ishte bazë e formimit të “shteti komb” dhe “minoriteteve” (komunitetet tjera më të vogla, cilatdo shprehje që përdoren për t’i përkufizuar në vende të ndryshme). Modeli i dytë (“post-impe-

rial”) është tipik për Bashkimin Sovjetik dhe Jugosllavinë. Këtu, së paku zyrtarisht, nuk kishte komb “kryesor” ose minoritete, por një strukturë e ndërlikuar hierarkike e komuniteteve kombëtare/etnike me ose pa formacionet e tyre shtetërore/administrative, të bashkuar në një lloj të ri, “më të lartë” të formacionit – “Populli Sovjetik” dhe “Jugosllavët”.

Mirëpo, qasjet e ndryshme të politikës shtetërore ndaj romëve në vendet e Evropës lindore, nuk do të thonë që në nuk mund të identifikojmë parimet, rregullat dhe modelet e përbashkëta. Këto karakteristika të përbashkëta të politikës shtetërore ndaj romëve, çfarëdo të jenë dallimet dhe specifikat në realizimin e tyre, janë treguese në përgjithësi për romët në Evropën jugore gjatë një periudhe fikse (në mes të fundit të Luftës së

Dytë Botërore dhe “erës së ndryshimit” kah fundi i viteve të 1980-ta e më tej).

## VENDOSJA E ROMËVE SHËTITËS

Vendosja e romëve është shembull tipik i kombinimit të politikave të përbashkëta dhe specifike në kuadër të politikave shtetërore në vendet e Evropës lindore. Çka është e përbashkët në këtë rast, është se proceset e vendosjes (ose së paku kufizimi domethënës i nomadizmit) së romëve shëtites shpaloseshin gjatë tërë periudhës së ekzaminuar në tërë Evropën lindore. Mirëpo, këto procese në vendet individuale kanë veçoritë e tyre në format e politikave shtetërore që i drejtonin ata dhe dallimet në kohën e realizimit të tyre.

III. 8

*Në disa regjione të Evropës lindore ende punojnë në profesione që nuk kërkojnë banim të përhershëm fiks. Zejet shëtitëse deri në një masë kanë mbijetuar masat e regjimeve komuniste për t'i bërë romët të vendoseshin dhe trendin e përgjithshëm drejt vendosjes. Për shembull, deri më sot, ekzistojnë trajnues të arinjve, që ua prezantojnë kafshët e tyre turistëve në bregun e Detit të Zi, dhe tregtarë kuajsh.*



III. 9

*“Në Hungari, ekziston një numër i vogël i kooperativave të farkëtarëve të cilat udhëhiqen nga romët në emër të tyre. Kooperativa farkëtare e Nogradmegyer, për shembull, ka ekzistuar që nga viti 1951. Fshati ishte banuar nga manykirët dhe muzikantët Cigan, të dy grupet përmes një procesi të gjatë themeluan kooperativën, që sot prodhon një shumëllojshmëri të produkteve.”*

(përkthyer nga Gronemeyer / Rakelmann 1988, f. 121f.)

#### VENDOSJA E NOMADËVE: SHTYPJE APO NDIHMË?

*Nuk ka dyshim që pyetja se si sot shihet çështja e vendosjes së nomadëve në Evropën lindore është interesante. Në shumë publikime shkencore dhe për të drejtat e njeriut kjo politikë shihet si kulmi i politikave represive të partive komuniste ndaj romëve. Kjo pikëpamje gjithashtu ndahet nga disa aktivistë të sotshëm romë, të cilët vijnë nga grupet rome, të cilat ishin vendosur për shekuj me radhë. Në përgjithësi, në Evropën lindore vetë romët dhe posaçërisht ish romët udhëtues kanë një qëndrim pozitiv ndaj masave për vendosje. Këto shprehen më së miri nga ata të cilët jetuan përmes ngjarjeve. Qëndrimi pozitiv për shembull është më i fortë në Bullgari ose në vendet e ish Bashkimit Sovjetik, sesa në Çekosllovakia dhe Poloni, ku vendosja është shoqëruar me masa represive (konfiskimi i kuajve dhe pronës).*

*Një faktor tjetër është shumë më i rëndësishëm kur vlerësojmë politikën e vendosjes së romëve nomad. Gjatë periudhës prej viteve të 1950-ta deri në vitet 1970-ta në vendet e Evropës lindore një krizë serioze kishte filluar të ndikonte në mënyrën nomade të jetesës. Për shkak të kushteve të ndryshuara sociale edhe ekonomike vetë nomadët u detyruan të kërkonin mundësitë për tu vendosur (ose të jetonin një mënyrë gjysmë-nomade të jetës). Ndërhyrja aktive e shtetit erdhi në një moment të duhur historik (që është një ngjarje e rrallë në historinë e politikave shtetërore ndaj romëve) dhe në mënyrë substanciale asistoi në zhvillimin natyror të komunitetit dhe integritetit të tij (për shembull përmes dhënies së huave dhe subvencioneve për ndërtimin e vendbanimeve).*

III. 10

Pikat fillestare të proceseve të vendosjes në vendet e Evropës lindore gjithashtu dallojnë në një shkallë të madhe. Natyrisht se është e pamundur të përmenden të dhëna të sakta, por mund të supozojnë se 3/4 e romëve në Poloni dhe së paku 2/3 e popullatës së tërësishme rome në Bashkimin Sovjetik ishin (gjysmë-) nomadë. Në anën tjetër ishin Bullgaria dhe Çekosllovakia, ku romët shëtitës që i nënshtroheshin politikave qeveritare ishin më pak se 5% e tërë popullsisë rome. Në vendet tjera ndarja relative e romëve nomad dallonte, që do të thotë se në Rumani dhe Jugosllavi romët shëtitës nuk ishin më shumë se 1/3, dhe në Hungari dhe Shqipëri jo më shumë se 1/4 e numrit të përgjithshëm të romëve.

Nëshumicëne vendet e Evropës lindore vendosja e romëve nomad u bë

përmes akteve qeveritare apo vendimeve partiake (që ishte e njëjta gjë). Bashkimi Sovjetik, ku një ligj special ndalonte mënyrën shëtitëse të jetës, ishte vendi i parë që ndërmori një politikë aktive për zgjidhjen e “problemit” të romëve nomad. Me 5 tetor, 1956, Presidium i Sovjetit Suprem të BRSS-së lëshoi një dekret mbi “Përfshirjen e Ciganëve shëtitës në aktivitete punuese”. Modeli i njëjtë u aplikua në Bullgari, ku u miratua një dekret për “Zgjidhjen e çështjeve të minoritetit Cigan në Bullgari” nga Këshilli i Ministrave në vitin 1958. Në Çekosllovakia një ligj mbi “Vendosjen e personave shëtitës” u miratua në të njëjtin vit; dallimet në thelb janë të parëndësishme. Në Poloni, pas përpjekjes së pasuksesshme të qeverisë për të bindur romët shëtitës të vendoseshin vullnetarisht në

territoret e lira perëndimore (pas dëbimit të popullsisë gjermane) në vitin 1952, Ministria e Punëve të Brendshme lëshoi një vendim për vendosjen e obligueshme të “Ciganëve” shëtitës në vitin 1964. Në Rumani masat speciale për vendosjen e “Ciganëve” shëtitës filluan pas vitit 1977 kur Komiteti Qendror i Partisë Komuniste Rumune miratoi një program për integrimin e tyre social. Në këtë program vendosja është një nga çështjet e adresuara, por jo edhe më e rëndësishmja.

Në vendet tjera të Evropës lindore vendosja e romëve nomad nuk rregullohej me ndonjë politikë speciale ndaj tyre, por në kuadër të legjisllacionit të përgjithshëm (kërkesa për një vend fiks të banimit, një vend fiks të punës, etj). Në Hungari ky proces ndodhi gjatë gjysmës së dytë të viteve të 50-ta, ndërsa në

## POLONIA: EFEKTET E VENDOSJES SË DETYRUESHME

« Au moment de la mise en œuvre de la politique de sédentarisation [en 1964], les autorités ont simplement négligé de préparer le moindre plan permettant aux Roms de commencer une nouvelle vie. Aucun logement décent ne leur a été proposé, aucun emploi et rien qui puisse permettre aux intéressés de s'adapter progressivement à une société plus large et à modifier leurs modes de vie antérieurs. Lorsqu'ils se voyaient attribuer des appartements sociaux au milieu de « gens ordinaires », des conflits ne tardaient pas à surgir. [...] Pendant les années qui ont suivi, une fois les Roms suffisamment dissuadés de reprendre leurs pérégrinations, les autorités n'ont quasiment plus témoigné le moindre intérêt à leur égard. C'est à cette époque que les schémas roms d'adaptation à cette nouvelle vie ont été établis. Les Roms se sont tournés vers le commerce des devises et des objets de valeur : principalement l'or, les voitures, les antiquités et les tapis. Ceux qui avaient de la famille à l'étranger avaient davantage l'occasion de gagner leur vie en faisant de la contrebande ou en vendant des voitures volées en Europe de l'Ouest. »

III. 11 (nga Mróz 2001, f. 257f.)



III. 12

“Punëtorët më të mirë Cigan të punës socialiste”. Sofia, fundi i viteve të 1940-ta, në mes Shakir Pashov, atëherë deputet në Bullgari.

(nga arkivat e Studii Romani, Sofia, Bulgaria)

Shqipëri dhe Jugosllavi në vitet e 1960-ta dhe 1970-ta.

Duhet të theksohet se politikat shtetërore për vendosjen e romëve nomad nuk arrinin gjithmonë rezultate të dëshiruara. Në Bashkimin Sovjetik një pjesë e romëve, që u vendosën zyrtarisht, vazhduan me mënyrën e vjetër të jetesës deri në vitet e 1960-ta kur gradualisht filluan t'i kthehen aktiviteteve të reja ekonomike. Mënyra shëtitëse e jetesës në përgjithësi është duke u shuar (por jo edhe zhdukur në tërësi) për shumicën e romëve në Jugosllavi. Në Bullgari disa grupe rome, pavarësisht nga posedimi i banimit dhe punësimi i rregullt formal, vazhdojnë të udhëtojnë gjatë stinëve të ngrohta (që ishte model tradicional për mënyrën nomade të jetesës në Ballkan). Kjo politikë e vendosjes kishte rezultatet më të varfëra në Rumani, ku në vitin 1977 regjistrimi zyrtarisht deklaroi 66,500 romë nomad dhe ku modeli i nomadizmit stinor ka mbijetuar deri më sot në grupe të ndryshme të romëve. [Illa. 2-10]

### INTEGRIMI I PËRSHPEJTUAR

Politika e drejtuar kah integrimi publik i romëve dominoi në të gjitha vendet e Evropës lindore, edhe pse, realizimi i saj

kishte forma të ndryshme. Ekzistojnë dy qasje të ndryshme, që janë temë edhe sot: “ajo mbizotëruese” dhe “ajo speciale”. “Qasjes mbizotëruese” i mungojnë masat speciale shtetërore për integrimin social të romëve, që do të thotë se romët trajtohen në kuadrin e politikave ekzistuese mbizotëruese për tërë popullsinë. “Qasja speciale” trajton romët si një komunitet i ndarë me probleme specifike, që parakupton masa specifike për zgjidhjen e tyre.

Qasja e parë është tipike mbi të gjitha për Bashkimin Sovjetik, Jugosllavinë, Poloninë dhe Shqipërinë ku nuk ka programe speciale qeveritare për romët (në BRSS dhe Poloni është një përjashtim— programi për vendosjen e shëtitësve). Sfera e vetme e jetës publike, ku parimi i politikës mbizotëruese për romët nuk është aplikuar, ishte ruajtja dhe zhvillimi i identitetit të tyre etnokulturor. Teatri romë në BRSS ishte një nga pamjet më të famshme në Moskë; ekzistonin përmbi 100 ansamble muzikore dhe vallëzuese rome, nën institucione të ndryshme, dhe muzika rome incizohej dhe kishte qarkullim të gjerë, së bashku me folklorin “Cigan”. Situata në Jugosllavi, me përkrahjen aktive të shtetit, është engjashme. Situata është disi engjashme në Poloni, edhe pse në një shkallë më të kufizuar. [III. 11]

Në katër vendet tjera (Çekosllovakia, Hungari, Rumani dhe Bullgari) mbizotëronte një qasje “speciale” në politikën shtetërore për integrimin publik të romëve. Prania e një qasjeje të tillë nuk e përjashtonte “qasjen mbizotëruese”, dhe në shumë raste integrimi publik i romëve u bë brenda në kuadrin të legjislacionit të përgjithshëm. Mirëpo, për çështje speciale shteti vendoste që masat speciale për romët ishin të domosdoshme. Politikate vendosjes së romëve ishin vetëm një nga shembujt në këtë aspekt. [III. 14]

Në Bullgari, “Zgjidhja e çështjeve të minoritetit Cigan në Bullgari” u miratua në vitin 1958, dhe në vitin 1978 u mbështet nga një dekret “Mbi përmirësimin e mëtejshëm të punës për Ciganët bullgar, për përfshirjen më aktive të tyre në ndërtimin e shoqërisë së zhvilluar socialiste”; Partia Komuniste Rumune përgatiti një “Program për Integrimin Social të Ciganëve”; dhe në Çekosllovakia – pas ngjarjeve të vitit 1968 dhe miratimit të kushtetutës së re— “Koncepti për integrimin e përgjithshëm publik dhe kulturor të Ciganëve” u lëshua në vitin 1972, dhe u zhvillua dhe ndryshua më tej në vitin 1976. Si tërësi, të gjitha këto dokumente partiake dhe qeveritare përmbajnë disa udhëzime kryesore, që politika speciale shtetërore për “Ciganët” duhet t'i përmbushë. Ato përcaktojnë dhënien e

### “KUAJT, LOPËT DHE CIGANËT”

ILL. 13 (NGA GUY 2001, F. 291)

*“Dekreti i Qeverisë 502/ 1965 futi një program të planifikuar për transferimin e romëve nga vendbanimet e stër ngarkuara në Sllovaki dhe vendosjen e tyre në lokacione më të përshtatshme në tokat çeke. Proporcioni maksimal i*

*lejueshëm i romëve për komunitet u caktua të jetë 5 përqind. [...] Sikurse zëdhënësi romë komentoi në mënyrë të hidhur: ‘Ata planifikojnë numrat për secilin fshat – kuajt, lopët dhe Ciganët [...]’*”

### POLITIKAT “MBIZOTËRUESE” ME EFEKTE “SPECIALE”: STERILIZIMI NË ÇEKOSLLOVAKI

ILL. 14

*Sterilizimi në Çekosllovakë zakonisht konsiderohet si një shembull drastik i politikës “speciale” ndaj romëve në Evropën lindore – në këtë rast ajo që përmendet është dekreti i lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë më 29 shkurt, 1972, duke mundësuar sterilizimin vullnetar të grave, të cilat kishin lindur më shumë se katër fëmijë mentalisht të sëmurë, të shoqëruar me një stimul financiar. Ky dekret, i cili në teori ishte në pajtim me parimet “mbizotëruese” të politikave (që do të thotë nuk iu ishte adresuar drejtpërdrejtë romëve), i përsëriti (në një mënyrë*

*më të butë) normat dhe praktikën e ngjashme shtetërore në Zvicër dhe në vendet skandinave. Mirëpo, shembulli ilustron se teknikisht politikën “mbizotëruese” mund të shpëjë në rezultate “speciale” dhe shpesh diskriminuese në praktikë. Në vend të aplikoheshin ndaj anëtarëve që të një shoqërie të caktuar, kufizimet kanë tendencë t’i shqiptohen atyre që veç janë të kufizuar. Në rastin e sterilizimit “vullnetar” në Çekosllovakë, më shumë se gjysma e grave të nënshtruara sterilizimit në vitet e 1970-ta ishin gra rome.*

punësimit të plotë dhe të qëndrueshëm, zgjidhjen e problemeve të banimit dhe shëndetit, përfshirjen e fëmijëve romë në sistemin arsimor, dhe përmirësimin e nivelit të tyre arsimor, promovimin e kulturës rome etj. [III. 12]

Sidoqoftë, gjithashtu janë një numër i pikave specifike në politikën shtetërore në disa vende, posaçërisht në realizimin specifik të sfera kryesore të përmendura. Në Bullgari shkollat e reja me konvikte filluan të themelohen nga viti 1961, dhe nga viti 1966 disa nga shkollat, në të cilat shkonin fëmijët romë, u transformuan në “Shkolla të mesme të përgjithshme me theks në trajnimin e punës”. Në Rumani masa speciale u morën për zvogëlimin e numrit të fëmijëve në familjet rome (ndihmat u jepeshin vetëm familjeve deri me 5 fëmijë), për shkak të numrit të madh të fëmijëve romë të braktisur në spitale dhe jetimore. Në Hungari në vitin 1961, masat speciale u parapanë kundër diskriminimit të romëve në shoqërinë hungareze, dhe programi i banimit i vitit 1964 parashihte likuidimin e 2,500 vendbanimeve të ndara rome. Në Çekosllovakë, një dekret qeveritar në vitin 1965 gjithashtu parashihte shkatërrimin e lagjeve rome, kryesisht në Sllovakinë lindore, dhe shpërndarjen e romëve që jetonin aty në fshatrat dhe qytetet sllovaqe dhe në regji-

onet industriale të Republikës Socialiste Çeke. [III. 13]

### TRASHËGIMIA KULTURORE DHE HISTORIKE

Dallimet në politikën shtetërore në disa vende shpesh përcaktohen ose së paku ndikohen nga modelet e hershme kulturore dhe historike. Në fakt, këto vende të Evropës lindore morën formën në shekujt 19 dhe 20, bazuar në tri perandori – Perandorinë Otomane, Perandorinë Austro-Hungareze dhe Perandorinë Ruse, ku secila ofroi modele të ndryshme të politikës shtetërore drejt romëve. Specifikat e këtyre modeleve kryesore dhe ndikimi i tyre në fazat e mëvonshme historike mund të ilustron me shembullin e politikave të banimit në vendet e ndryshme të Evropës lindore.

Specifikat e vjetra imperiale, kulturore dhe historike të tri perandorive drejtpërdrejtë pasqyrohen në modelet e ndryshme të rivendosjes së romëve të vendosur (që në mënyrë të konsiderueshme mbizotëruan ndaj romëve nomad në Perandorinë Otomane dhe Perandorinë Austro-Hungareze). Në Perandorinë Otomane (respektivisht Bullgari, Shqipëri, dhe

një pjesë e madhe e Jugosllavisë dhe Rumanisë) romët jetuan brenda zonës së banimit, në lagjet e tyre etnikisht të përcaktuara, të quajtura “mahala”, si komunitetet tjera etnike. Në Perandorinë Austro-Hungareze (respektivisht Hungari, Çekosllovakë, pjesët më të mëdha të Rumanisë dhe pjesët e vogla të Jugosllavisë dhe Polonisë) romët jetuan në vendbanimet e tyre, përtej kufizimeve të vendbanimit, nganjëherë me kilometra larg, në të ashtuquajturat “ciganytelep” në Hungari, “osada”, “kolonia” në Sllovaki, “kolonia”, “tigania” në Rumani, “osada” në Poloninë jugore etj. Në Perandorinë Ruse (përkatesisht BRSS dhe një pjesë e Polonisë) romët më së shpeshti jetonin të përzier me pjesën tjetër të popullsisë, zakonisht në një ose disa dhjetëra shtëpi njëra afër tjetrës (me përjashtim të Transcarpathia ku modeli Austro-Hungarez mbizotëron).

Politika përkatëse shtetërore për romët në vendet e Evropës lindore është në pajtim me këto rrethana të përcaktuara historikisht. Në Hungari dhe Sllovaki, tendenca është drejt likuidimit total të vendbanimeve të ndara rome; këta hapa ishin mjaft efektiv në Hungari, ku shumica e rreth 2,500 “ciganytelep” u shkatërruan. Në Rumani politika shtetërore në sferën e banimit

## EMANCIPIMI NË JUGOSLLAVI

III. 15 (nga Kenrick 2001, f. 406)

*“Përkundër tensioneve ndëretnike dhe politike pas vdekjes së Titos në vitin 1980, romët e parë ishin zgjedhur në këshillat komunale dhe Sait Balić nga Nishi u bë anëtar i Parlamentit Nacional Serb. Katër vjet më vonë veç ishin pesëdhjetë e tre romë që u zgjodhën si anëtarë të këshillave*

*komunale dhe krahinore përveç një ulëses në Parlamentin Serb [...]. Në vitin 1981 radio programi i parë dygjuhësor, në Romani dhe gjuhën serbe, ishte transmetuar nga Beogradi, i quajtur ‘A šunen romalen’ (Dëgjoni, Romë) dhe emisioni vazhdoi deri në vitin 1987.”*

## BULLGARI: FSHEHJA E ROMËVE

III. 16

*Bullgaria u shpall si shtet unitar (një-komb) pa asnjë kombësi në të; “Turqve bullgar” iu atribuu origjina bullgare, dhe ata u detyruan të merrnin identitetin turk në Perandorinë Otomane. Pasi që një arsyetim i tillë “shkencor” nuk mund të gjendej për romët, për të dëshmuar origjinën e tyre bullgare, zyrtarisht ata pushuan së ekzistuari. Nuk përmendeshin romët*

*në vendet publike, në media dhe në publikimet akademike, dhe në një numër të vendeve përgjatë linjave hekurudhore dhe autostradave lagjet e romëve fshiheshin pas mureve të betonit. Kjo politikë absurde dështoj të arrinte rezultate dhe nuk ndihmoi në integrimin e suksesshëm të romëve në shtetin bullgar; përkundrazi, efekti i kundër u arrit.*

është e ndryshme dhe e paqëndrueshme, sikurse është trashëgimia historike në regjionet e ndryshme të vendit. Në Bullgari, dekretet ekzistuese për largimin e lagjeve rome nuk u përcollën me aktivitete serioze, ndërsa në Jugosllavi dhe Shqipëri – sikurse edhe në Bashkimin Sovjetik dhe Poloni – nuk ka ndonjë politikë speciale shtetërore ndaj romëve.

**OORGANIZATAT –  
“LËVIZJET ROMANI”  
NË JUGOSLLAVI**

Një tipar i rëndësishëm i politikës shtetërore ndaj romëve në vendet e Evropës lindore është qëndrimi ndaj organizatave rome. Në fakt, vetë themelimi dhe zhvillimi i organizatave të tilla nuk ishte i mundur pa miratimin dhe përkrahjen aktive të shtetit dhe strukturave partiake. [III. 15]

Kundër kësaj historie, shtyrja për vetë-organizim dhe emancipim, që gradualisht ishte zhvilluar në mesin e romëve në Evropën perëndimore, dhe që shpiti në themelimin e organizatave të ndryshme dhe përfundimisht edhe në fillimin e të ashtuquajturës “Lëvizje Romani” nga vitet e 70-ta e më tej, nuk arriti rezultate të krahasueshme në Lindje. Prapë se prapë, kishte pak a shumë iniciativa të rralla dhe afatshkurta në Bullgari dhe Çekosllovakia. Në Hungari,

u mbajtën një numër i konsiderueshëm i aktiviteteve kulturore.

Situata në Jugosllavi është një rast specifik. Në artikullin e vitit 1969 të buletinit “Vecherni Novosti” në Beograd, Slobodan Berberski, një romë dhe funksionar komunist me përvojë, i burgosur politik, luftëtar i rezistencës në Luftën e Dytë Botërore, dhe anëtar i Komitetit Qendror të Unionit të Komunistëve Jugosllav (UYC), njoftoi se romët jugosllav do të krijonin organizatën e tyre, e cila si qëllim kryesor kishte asistimin e romëve për arritjen e statusit të një “kombësie” (në atë kohë Jugosllavia kishte një legjislacion shtetëror dhe sistem hierarkik të ndërlikuar, që i ndante komunitetet e saj në kategori të ndryshme – grupe etnike, kombësi, dhe kombe).

Pas krijimit të “Shoqatës Rome” në vitin 1969, filloi procesi i krijimit të degëve në republikat e ndryshme dhe më vonë edhe në qytete, së bashku me krijimin e shoqatave tjera rome (kulturore, sportive, etj.). Në vitet e 1970-ta, më shumë se 60 organizata rome ekzistonin dhe numri i tyre vazhdimisht rritej. Iniciativat e ndryshme, ngjarjet kryesisht kulturore (përfshirë ansamblet, festivalet rome), u përkrahën nga Shteti Jugosllav; librat u publikuan në gjuhën Romani, filloi transmetimi radio dhe televiziv (në Kosovë). Në vitin 1986, shoqatat ekzistuese rome u bashkuan në një Union të Shoqatave Rome në Jugosllavi.

**INTEGRIMI PUBLIK  
DHE/OSE  
ASIMILIMI**

Kur përmenden politikat shtetërore ndaj romëve në Evropën lindore gjatë të ashtuquajturës “periudhë socialiste”, vlerësimet deri më sot mbesin në shpirtin e “Luftës së Ftohtë”. Këto politika, si tërësi dhe në manifestimet e tyre konkrete, shihen si të ngjashme me krimet e shumta të regjimeve totalitare. Shikuar nga pikëpamja e klisheve ideologjike, sot është vështirë të gjendet një analizë objektive dhe gjithëpërfshirëse të këtyre politikave shtetërore në gjerësinë e tyre.

Problemi kryesor këtu është të arrihet në një dallim të saktë për të vendosur marrëdhëniet në mes të dy proceseve të ndërlikura dhe shpesh të mbuluara njëra me tjetrën – proceset e integrimit shoqëror dhe asimilimit. Gjatë historisë shumë njerëz, të cilët jetonin të rrethuar nga popujt e huaj, përkrahën rrugën e tyre prej integrit social në asimilim (si një proces natyror ose si rezultat i një politike të caktuar shtetërore). Duke përcjellur logjikën e këtij modeli (që në asnjë mënyrë nuk është universale), dhe duke e zbatuar atë tek romët, çdo masë shtetërore në Evropën lindore e drejtuar kah romët mund të konsiderohej si një hap drejt asimilimit.

III. 17

*Shtëpitë e romëve (në plan të parë) dhe banesat në Filákovo, Sllovakia jug-lindore. Në vitet e 1970-ta, hapësira në mes u pastrua nga kasollet e romëve, dhe banorët u vendosën në banesat rishtas të ndërtuara. Në fabrikat e çelikut (oxhaku në prapavijë) 8,000 njerëz u punësuan, në mesin e tyre me qindra romë (deri në vitin 1989). Pas ndryshimit, fabrika u shit dhe u ri-themelua si pjesë e një kompanie multinacionale. Sot, nga 800 njerëz që punojnë në fabrikë, asnjëri nga ta nuk është i origjinës rome.*

(nga dROMa 1/2004, f. 10)



Bullgaria është i vetmi vend në Evropën lindore ku politika e integritit të romëve përfundon në një politikë të drejtpërdrejtë të asimilimit të plotë dhe të pakushtëzuar. Këtu qëndrimet ndaj romëve i nënshtrohen politikës së drejtuar kah minoriteti turk. Një vendim i “Politburos” në vitin 1962 tregon “tendencat negative të Turqifikimit” në mesin e myslimanëve bullgar, “Ciganëve” dhe Tatarëve; ajo çka pasoi gradualisht ishte politika e “inkurajimit” për të ndërruar emrat Turk-Arab në emra bullgar. Faza e fundit e kësaj politike ndërli dhej me të ashtuquajturin “proces ringjallës” në dimër të vitit 1984-1985 kur aksioni masiv, përfshirë shërbimet e sigurimit, detyroi të gjithë turqit, myslimanët bullgar (Pomakët) dhe romët mysliman që t’i ndërronin emrat. Në fakt, ky “proces i ringjalljes” ishte një asimilim i detyruar, i zbatuar me dhunë në fazën e tij të fundit. [Illa. 16, 17]

Tendencat asimiluese ndaj romëve gjithashtu mund të gjendeshin në politikat shtetërore në Hungari, Çekosllovakia, dhe në një masë të caktuar edhe në Rumani. Në vitet e 1950-ta dhe 1960-ta kishte bisedime, pak a shumë të hapura, për “asimilimin natyror të Ciganëve” në shoqërinë hungareze. Në vitet e 1970-ta, logjika e politikës shtetërore veç ishte e ndryshme, duke marrë një shpirt konstruktiv, në aspektin modern të fjalës. Shteti hungarez

filloi të përkrahte integrimin e romëve në shoqëri, si dhe ruajtjen dhe zhvillimin e kulturës së tyre etnike, mirëpo nuk iu dha statusin e minoritetit nacional, ashtu siq iu dha komuniteteve tjera minoritare. Përfundimi logjik i kësaj qasjeje ishte gjithashtu asimilimi, edhe pse me kalimin e kohës.

Politika ndaj romëve në Çekosllovakia zbatoi politika mjaft të ngjashme. Këtu – sipas normave zyrtare – romët përkufizoheshin si një komunitet i natyrës së ndryshme, që nuk mund të krahasohej me minoritetet tjera, me një status të ndryshëm (“qytetarët e origjinës Cigane”). Politika ndaj romëve u definua si “integrim social” dhe “akulturim”, mirëpo në praktikë kishte kuptimin e drejtimit të zhvillimit kah asimilimi i ardhshëm (duke mos u formuluar drejtpërdrejtë si e tillë në dokumentet zyrtare partiake dhe shtetërore.

Situata në Rumani ishte disi e ngjashme. Këtu asimilimi i romëve në shoqërinë rumune ka rezultuar në shfaqjen e grupeve të mëdha të njerëzve me origjinë rome, të cilët kanë humbur (tërësisht ose pjesërisht) identitetin e tyre romë dhe karakteristikat etnike dhe kulturore. Shteti rumun nuk e mori seriozisht këtë proces dhe për këtë arsye nuk i kushtoi shumë vëmendje romëve, duke i konsideruar problemet tyre si sociale dhe jo etnike. [III. 18]

Nuk do të ishte e arsyeshme të flitet për qëndrimet dhe tendencat asi-

miluese në politikat shtetërore ndaj romëve, madje as nga pikëpamja afatgjatë, në vendet tjera të Evropës lindore. Në fakt, në Poloni dhe Shqipëri, që janë vende të bazuara në modelin “një-kombësh”, politika shtetërore ndaj romëve ishte aq e parëndësishme, sa që nuk mund të shikohet në këtë kontekst. Në të vërtetë, romët në Jugosllavi ngritën çështjen e fitimit të një statusi zyrtar, të barabartë me popujt tjerë, mirëpo mungesa e një statusi të tillë nuk mund të interpretohet si përkrahje e një politike asimiluese (përfundimisht atyre iu dha ky status pak para shpërbërjes së Jugosllavisë). Koncepti i “Yugoslavimit” parakuptonte transformimin e të gjithë popujve në një lloj të ri të komunitetit (“Jugosllavët”), por prapë kjo nuk nënkuptonte asimilimin preliminar të romëve në kombe tjera.

Situata ishte e ngjashme në BRSS, ku sidoqoftë, romët ishin një komunitet mjaft i parëndësishëm (në krahasim me shkallën e etnive të ndryshme në Bashkimin Sovjetik) dhe do të ishte naive të flitej për një politikë speciale për asimilimin e tyre. Ajo çka mbizotëroi në Bashkimin Sovjetik ishte një koncept shtetëror i ardhmërisë së “popujve Sovjetik” (një metaforë, e ngjashme me konceptin e sotshëm të “familjes së përbashkët evropiane”), që parakuptonte bashkimin e të gjithë popujve në një formacion të ri cilësor.

RUMANIA:  
ROMËT SI SHËNJESTËR SEKONDARE E “SISTEMATIZIMIT”

*Politika e njohur e “sistematizimit” e kryer nga Nicolae Ceausescu në vitet e 1970-ta dhe 1980-ta përfshinte shkatërrimin masiv të lagjeve të ndara urbane dhe rurale dhe të fshatrave të tëra dhe vendosjen e banorëve në vendbanimet e reja. Kjo kryesisht u realizua në Transylvania, e cila gjithashtu shpiti në migrimin e brendshëm të romëve brenda Rumanisë. Mirëpo, kjo politikë nuk u drejtua krye-*

*sisht ndaj romëve, siç mendohet nganjëherë, por në aspektin nacional më shumë u drejtua ndaj zvogëlimit të minoritetit hungarez, dhe romët në këtë rast ishin konsideruar si përfaqësues të shumicës, që do të thotë të shtetit rumun, kështu që qëllimet e asimilimit lidhur me romët u lanë të marrin rrjedhën e tyre natyrore në të ardhmen e largët.*

III. 18

## PËRFUNDIMI

Nëse konsiderojmë se jemi duke analizuar një rezultat përfundimtar nga pikëpamja e sotshme dhe se kriteri më i rëndësishëm është arritja e një niveli më të lartë të integritimit, ndërsa ruhen karakteristikat etnike dhe kulturore, mund të përmbledhim se në tërësi politika shtetërore (jo një politikë e vetme!), pavarësisht nga qëllimet e parashtruara, përfundimisht ka arritur rezultate goxha të ndryshme për romët në Evropën lindore. Në njërin anë, kushtet jetësore të romëve dhe niveli i tyre arsimor

janë përmirësuar në mënyrë rapide në krahasim me periudhat e kaluara historike, niveli i integritimit të tyre është rritur, dhe një shtresë e konsiderueshme e romëve relativisht të edukuar është shfaqur etj. Sidoqoftë, në anën tjetër, çmimi i paguar për këtë integritim është mjaft i madh. Shumë romë në Evropën lindore vazhdojnë rrugën e degradimit social dhe kufizimit, një proces që është rritur në mënyrë të konsiderueshme dhe ka arritur thellësitë e reja pas “erës së ndryshimit”. Ajo çka është treguese është se këto procese më së miri shprehen dhe ndihen më të forta

në vendet me politika specifike dhe qartësisht të formuluar ndaj romëve (në Republikën Çeke dhe Sllovaki, Hungari, Rumania dhe Bullgari) dhe në një shkallë më të vogël politikave të tilla janë kufizuar ose thjeshtë mungojnë. Rezultatet përfundimtare të politikave ndaj romëve në vendet e Evropës lindore arrihen mbi të gjitha për shkak të zhvillimit të përgjithshëm social dhe politikës “mbizotëruese” ndaj romëve (që do të thotë politikën e njëjtë si ndaj qytetarëve tjerë), dhe në një masë më të vogël për shkak të politikave “specifike” ndaj romëve si komunitet i ndarë.

## Bibliografia

*Achim, Viorel (1998) Țigani în istoria României. București: Editura Enciclopedică* | *Barany, Zoltan (2001) The East European Gypsies. Regime Change, Marginality, and Ethnopolitics. Cambridge: Cambridge University Press* | *Crowe, David M. (1995) A History of the Gypsies of Eastern Europe and Russia. London / New York: I. B. Tauris Publishers* | *Davidova, Eva (1995) Romano Drom. Cesty Romu 1945-1990. Zmeny v Postaveni a Zpusobu Zivota Romu c Cechach, na Morave a na Slovensku. Olomouc: Palacky University* | *Djurić, R. / Becken, J. / Bengsch, A. B. (1996) Ohne Heim - Ohne Grab. Die Geschichte der Sinti und Roma. Berlin: Aufbau Verlag* | *Fraser, Angus (1992) The Gypsies. Oxford / Cambridge: Blackwell* | *Gronemeyer, Reimer (1983) Zigeunerpolitik in sozialistischen Ländern Osteuropas am Beispiel der Länder Ungarn, Tschechoslowakei, Polen. In: Gronemeyer, Reimer (ed.), Eigensinn und Hilfe. Zigeuner in der Sozialpolitik heutiger Leistungsgesellschaften. Giessen: Focus Verlag, pp. 43-183* | *Gronemeyer, Reimer / Rakelmann, Georgia A. (1988) Die Zigeuner. Reisende in Europa. Köln: DuMont Buchverlag* | *Guy, Will (2001) The Czech lands and Slovakia: Another false dawn?, in: Guy, Will (ed.) Between Past and Future: the Roma of Central and Eastern Europe. Hatfield: University of Hertfordshire Press, pp. 285-332* | *Kalinin, Valdemar (2003) Zagadki baltiiskikh tsygan (Rossiya, Estoniya, Litva, Latvija, Polsha). Vitebsk* | *Kenrick, Donald (2001) Former Yugoslavia: a patchwork of destinies. In: Guy, Will (ed.) Between Past and Future: the Roma of Central and Eastern Europe. Hatfield: University of Hertfordshire Press, pp. 405-425* | *Marushiakova, Elena / Popov, Veselin (1997) Gypsies (Roma) in Bulgaria. Frankfurt am Main: Peter Lang* | *Mróz, Lech (2001) Poland: the clash of tradition and modernity. In: Guy, Will (ed.) Between Past and Future: the Roma of Central and Eastern Europe. Hatfield: University of Hertfordshire Press, pp. 252-267*